

Përtej numrave



Performanca e Gjyqësorit
në luftën kundër korrupsionit

Mars 2017

Përtej Numrave

Performanca e Gjyqësorit në luftën kundërkorrupsionit*

Mars 2017

* Raporti është statistikor. Statistikat janë të kontrolluara dhe të vërtetuara. Statistikat në këtë raport janë statistika zyrtare të dalura nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.



Përtej Numrave

Performanca e Gjyqësorit
në luftën kundërkorrupsion

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	6
Hyrje.....	7
Informata për projektin.....	11
Gjykatat.....	12
Prokuroria.....	12
Vizitat në gjykata dhe prokurori - Memorandumet.....	13
Metodologjia.....	14
Mbledhja e të dhënave.....	19
Prezantimi i të gjeturave.....	20
Gjykatat Themelore – të dhëna për të gjitha gjykatat	20
Analiza e Numrave	30
Fluksi i lëndëve.....	31
Norma e zgjidhjes së lëndëve (CR).....	32
Trendi i nivelizimit të lëndëve bazuar në performancën e vitit 2016.....	33
Raporti i qarkullimit të lëndëve.....	35
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve (eng disposition time -DT).....	36
Indeksi i lëndëve të grumbulluara.....	37
Fluksi i lëndëve për shtatë gjykatat themelore.....	38
Norma e zgjidhjes së lëndëve (CR) për shtatë gjykatat themelore.....	39
Trendi i zgjidhjes së lëndëve (CR) bazuar në statistikat e vitit 2016 për shtatë gjykatat themelore.....	40
Norma e qarkullimit të lëndëve për shtatë gjykatat themelore.....	41
Kohëzgjatja përfundimit të lëndëve (eng disposition time -DT) për shtatë gjykatat themelore.....	42
Indeksi i lëndëve të grumbulluara për shtatë gjykatat themelore.....	43
Gjykatat Themelore 2016 / Statistikat antikorrupsion.....	44
Përfundim.....	54
Biblografia.....	56
Shënimet për gjykatat.....	59

Përmbledhje ekzekutive

Korrupsioni në Kosovë është cilësuar endemik nga Komisioni European në Raportin e Progresit. Luftimi i korrupsionit është kërkesa kryesore e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë për t'i hapur rrugë progresit shoqëror. Ky raport pasqyron përkushtimin e institucioneve të drejtësisë në luftimin e korrupsionit duke analizuar statistikën e kundërkorrupsionit të publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). Raporti mat performancën e gjyqësorit në luftën kundërkorrupsionit për vitin 2016. KGJK publikon vazhdimisht statistikën për gjykatat duke kontribuar në transparencën e gjyqësorit. Në këtë raport Lëvizja FOL i bën një analizë këtyre numrave duke i bërë më kuptimplota.

Metodologjia e Komisionit European për Efikasitetin e Drejtësisë është përdorur pjesërisht për të analizuar numrat. Të gjeturat tregojnë se gjyqësori ka një performancë të mirë në luftën kundërkorrupsionit në përgjithësi, por numri i lartë lëndëve të grumbulluara në disa rajone vazhdon të vonojë drejtësinë në disa gjykata. Gjykata e Prishtinës, për shembull, ka performancën më të dobët krahasuar me numrin e lëndëve, kurse Gjakova ka performancën më të mirë. Në njërin anë, raporti synon t'i shërbejë Gjyqësorit në përmirësimin e performancës në luftën kundërkorrupsionit kurse në anën tjetër synon t'u shërbejë qytetarëve që ta kuptojnë më mirë punën e gjykatave dhe përpjekjen e tyre për ta luftuar korrupsionin.

Hyrje

Luftimi dhe parandalimi i korrupsionit mbeten sfida kryesore për shoqërinë e Kosovës. Ndërtimi dhe zhvillimi i institucioneve demokratike po pengohet nga prezenca e madhe e korrupsionit në administratë publike.

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar është lloji më i përhapur i korrupsionit sipas të gjeturave të këtij raporti. Kushtëzimi i shërbimeve publike nga zyrtarë shtetërorë për përfitime personale, keqpërdorimi i pozitës zyrtare për përfitim personal, ushtrimi i presionit dhe ndikimit nga pozita zyrtare, pasurimi i paligjshëm janë të gjitha vepra korruptive të cilat pengojnë sundimin e ligjit dhe rrënojnë besimin në institucione.

Perceptimi i lartë i pranisë së korrupsionit tek institucionet publike dhe zyrtarët qeveritarë, bën që qytetarët t'i varin shpresat tek prokuroria dhe gjykatat si institucionet e fundit për të gjetur drejtësi dhe për t'i ndëshkuar të korruptuarit. Janë fillimisht prokurorët e pavaruar dhe profesionalë të cilët kanë guxim të hetojnë korrupsionin në cilindo nivel dhe pastaj gjyqtarët të cilët ndajnë drejtësinë dhe vendosin nëse ligji është i barabartë për të gjithë.

Gjyqësori* është ndër institucionet në të cilat qytetarët besojnë më së paku sipas pulsit publik, të publikuar nga UNDP-ja. Për vitin 2016, rreth 20% e qytetarëve shprehën kënaqshmëri me punën e gjyqësorit kurse afër 20% të tyre besuan se gjyqësori është i pavaruar në vendimet që merr (UNDP - Kosove 2016, 4,8).

Prania e madhe e korrupsionit në shoqëri bën që të bie besimi në të gjitha institucionet e shtetit, e në veçanti në ato të drejtësisë, të cilat janë shpresa e fundit e qytetarëve për të marrë drejtësi.

Komisioni European në Raportet e Progresit vazhdimisht ka dhënë alarmin për prani të madhe të korrupsionit në Kosovë, duke alarmuar se korrupsioni është duke u kthyer në sëmundje (COMMISSION 2015, 6).

* Shumë dokumente tjera gjyqësori nënkupton edhe gjykatat dhe prokurorinë, por në këtë raport me gjyqësor nënkuptojmë vetëm gjykatat. Psh. Dokumenti "Pulsi Publik" i publikuar nga UNDP Kosova. http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/publicpulse-11.html

Duke pasur fuqinë e kushtëzimit në procesin integruar, BE-ja vendosi kriteret të qarta për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, ku ndër kriteret kryesore ishte dëshmia me numra (European Commission 2016) nga gjyqësori në dënimin e korrupsionit të nivelit të lartë.

Kjo pati ndikim, pasi përpjekjet e gjyqësorit për të treguar performancë të mirë duken edhe në këtë raport. Për më tepër, u krijua edhe një listë e veçantë me zyrtarë të lartë të akuzuar për korrupsion*.

Megjithatë sistemi i drejtësisë vuan vetë nga i njëjti sindrom, pra korrupsioni. Kjo është konfirmuar nga Komisioni Europian i cili vëren se sistemi i drejtësisë është i prekur nga korrupsioni dhe ndikimi politik dhe ka mungesë të besimit të qytetarëve (European Commission 2016). Të njëjtat shqetësime ndajnë edhe Departamenti Amerikan i Shtetit dhe organizatat tjera ndërkombëtare dhe vendore (Department of State 2015).

Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit është thelbësore për funksionimin e një shteti demokratik. Besimi i qytetarëve se ata do të përballen me një proces të drejtë nga gjyqtarë profesionalë dhe të pandikuar nga politika apo korrupsioni është jetik për zhvillimin e shoqërisë demokratike.

Rritja e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë është proces që vazhdimisht duhet të ndërtohet dhe përmirësohet.

Hapi i parë padyshim është rritja e kriterëve të shkëlqyeshmërisë që mundëson që gjyqtarët të jenë profesionalë dhe me integritet**.

Hapi i dytë është hapja e gjyqësorit. Duke u lejuar qytetarëve të marrin pjesë dhe të shohin punën e gjyqësorit, qytetarët do të kontribuojnë jo vetëm në rritjen e besimit në institucionet e drejtësisë por do të rritet edhe cilësia e vendimeve gjyqësore***.

* Në takim me gjyqtarin në gjykatën e Ferizaj, z. Agim Maliqi, është pohuar se një listë prej 50 personave të nivelit të lartë të cilët janë të akuzuar për korrupsion, është krijuar si kërkesë e BE-së për të plotësuar kërkesën për rezultate në fushën e kundërkorrupsionit.

** Lëvizja FOL është duke skanuar sektorë të ndryshëm për të vlerësuar nivelin e integritetit në dy vitet e fundit. Në vitin 2017 skanimit të integritetit do t'i nënshtrohen edhe gjyqtarët edhe prokurorët.

*** Lëvizja FOL është duke punuar në hapjen e vendimeve të gjyqësorit në vitin 2017. Ligjet që bllokojnë transparencën dhe çenojnë besimin në institucione do të ndryshohen, ndërsa qytetarët do të kenë mundësi që t'i shohin të gjitha vendimet gjyqësore.

Ky hap kërkon përkushtim institucional nga institucionet rregulluese të drejtësisë siç është Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) si dhe Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi, natyrisht, edhe me presionin e shoqërisë civile.

Transparenca nënkupton që vendimet e gjyqtarëve të jenë të hapura për publikun e gjërë, për studiuesit e ligjit, për avokatët, për mediat dhe shoqërinë civile.

Gjyqësori ende konsiderohet njëri ndër sektorët më sekret të shoqërisë. Statistikat janë të papërpunuara dhe të pakuptueshme kurse procesi gjyqësor është pothuajse i mbyllur dhe dekuarajues për ata që monitorojnë këtë sektor (European Commission 2016).

Lëvizja FOL vazhdimisht punon për të rritur transparencën e institucioneve publike, duke përfshirë edhe gjyqësorin. Publikimi i këtij raporti me statistika për punën dhe performancën e gjykatave është një hap më tepër në këtë drejtim.

Raporti hedh dritë jo vetëm mbi punën e gjykatave në fushën e kundërkorrupsionit, që besojmë se do t'i shërbejë vetë gjykatave për t'u përmirësuar, por ai edhe i fton qytetarët që të njoftohen me punën e gjyqësorit, duke ndikuar në rritjen e besimit dhe krijimin e një perceptimi më të saktë.

Vetë gjyqësori ka bërë pak punë që ta përmirësojë imazhin e tij. Edhe ato pak arritje që janë shënuar nuk janë plasuar në formën e duhur dhe nuk kanë arritur tek qytetari. Ne besojmë se ky raport do të ndihmojë drejt së vërtetës.

Raporti është një dëshmi se gjyqësori është duke u munduar që të japë kontributin e tij në luftën kundër korrupsionit përkundër mungesës së besimit në të.

Lëvizja FOL është e gatshme t'i bëjë jehonë suksesit të gjyqësorit, njëjtë siç është e përkushtuar që ta kritikojë atë për dështimet. Ne jemi aleatë të të gjitha institucioneve që angazhohen për qeverisje të mirë dhe transparente; për të rritur liritë e qytetarëve; për të zhvilluar ekonominë, për të forcuar demokracinë dhe për të ngritur mirëqenien.

Por, për ta ndihmuar gjyqësorin dhe çdo institucion tjetër në Kosovë, ne kemi nevojë që ato të hapen për publikun, pasi ne jemi të bindur se transparenca është hapi më i rëndësishëm për të zbuluar të vërtetën dhe për të ulur perceptimet e gabuara.

Natyrisht se transparenca nuk është ilaç për të gjitha problemet që kanë institucionet, por ajo do të ndikojë që puna dhe mospuna e tyre të vëzhgohet nga qytetarët, do të mundësojë angazhimin e qytetarëve dhe të rrisë nivelin e llogaridhënies.

Ky raport është një përpjekje për ta rritur transparencën në sektorin e drejtësisë dhe për të shtuar ndikimin në ngritjen e performancës së gjyqësorit në luftimin e korrupsionit.

Ne besojmë fuqishëm se raporti do të mundësojë që vetë gjykatat të adresojnë problemet e efikasitetit në punën e tyre, duke kontribuar në ngritjen e performancës në përgjithësi.

Ne të gjithë përfitojmë nga një gjyqësor i pavarur, profesional dhe efikas.

Informata për projektin

Në shtator 2016, Lëvizja FOL ka marrë mbështetje në formë të grantit institucional nga programi ‘Promovimi i Shoqërisë Demokratike’ (DSP) i mbështetur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO –K), Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Përmes këtij granti institucional, Lëvizja FOL për 20 muaj do të monitorojë punën e prokurorisë dhe gjykatave dhe do të masë performancën e tyre në luftën kundër korrupsionit*.

Rezultatet që pritet të arrihen me këtë grant do të jenë; **a)** ndikim i shtuar në rritjen e performancës së institucioneve zbatuese të ligjit në prokurori dhe gjykata për të parandaluar, hetuar dhe gjykuar rastet korruptivesi dhe **b)** ndikim i shtuar në përmirësimin e legjislacionit në fushën e prokurimit publik për efektivitet dhe efikasitet më të lartë, si dhe ndikim në uljen e korrupsionit në prokurimin publik.

Në kuadër të projektit, Lëvizja FOL do të ndërmarrë, mes tjerash, këto aktivitete: **a)** Monitorim i gjykatave dhe prokurorive themelore në lëndët e nivelit të lartë të korrupsionit, matja e performancës dhe efikasitetit të gjykatave dhe prokurorive themelore në lëndët e korrupsionit, organizimi i tryezave për punën e gjykatave dhe prokurorive në lëndët e korrupsionit; **b)** monitorimi i ligjit për prokurim publik dhe raporte periodike në baza tremujore në lidhje me procesin e implementimit të prokurimit elektronik, tryeza të rregullta në baza gjashtëmujore për implementimin e prokurimit elektronik në Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrinë e Bujqësisë, publikim i raporteve përfundimtare për monitorimin e Strategjisë dhe legjislacionit relevant në fushën e prokurorisë dhe gjykatave si dhe prokurimit publik.

* Gjyqësori është vetëm njëra pjesë e monitorimit. Me të njëjtin grant, Lëvizja FOL do të monitorojë për 20 muaj edhe prokurimin publik në tri ministri. http://www.kcsfoundation.org/dsp/repository/docs/Grant_institucional_DSP_II_GI_-_10_zbatuar_nga_Levizja_FOL-ENG.pdf

Gjykatat

Projekti është i fokusuar në gjykata dhe në prokurori themelore. Gjykatat të cilat janë pjesë e monitorimit të këtij projekti janë gjykatat themelore në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan. Projekti do të masë performancën e gjykatave në fushën e kundërkorrupsionit përmes një metodologjie nga Komisioni European për Efikasitetin e Drejtësisë. Performanca do të matet duke shfrytëzuar statistikën që dalin nga vetë gjykatat por edhe dokumentet tjera, siç është Strategjia Kundër Korrupsionit 2013 – 2017*.

Kjo strategji ka katër objektiva në kuadër të zbatimit të ligjit. Dy nga këto objektiva: **1)** Rritja e nivelit të efikasitetit të institucioneve zbatuese të ligjit në prokurori dhe gjykata, për të parandaluar, hetuar dhe gjykuar lëndët korruptive dhe **2)** Rritja e profesionalizmit, pavarësisë dhe integritetit të institucioneve të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjykatave, do të jenë pjesë e monitorimit nga Lëvizja FOL. Monitorimi do të bëhet për pjesët e aktiviteteve dhe afateve të cilat vazhdojnë deri në 2017. Një vlerësim i strategjisë për të gjitha objektivat dhe aktivitetet në fushën e korrupsionit do të bëhet në gjashtëmujorin e fundit të vitit 2017, kur edhe përfundon strategjia. Këshilli Gjyqësor gjithashtu ka hartuar plan strategjik në vitin 2013 me titull “Strategjia kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra (KGJK 2013)”**. Nga kjo strategji, në raportet e ardhshme, FOL do të masë pjesën e përkushtimit të gjykatave në reduktimin e lëndëve të korrupsionit.

Prokuroria

Tek prokuroria, projekti do të monitorojë dhe masë performancën bazuar në statistikën e vetë prokurorive. Prokuroritë themelore në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan do të jenë pjesë e matjes së performancës dhe monitorimit. Përveç strategjisë kundërkorrupsionit 2013-2017, Prokuroria e Shtetit ka hartuar një strategji me titull “Prioritetet e Prokurorive Themelore në Kosovë në ndjekjen e kryesve të veprave penale dhe hetimin e veprave penale në përgjithësi dhe reduktimin e numrit të

* Në Shkurt ka filluar punën grupi i ri punues për hartimin e strategjisë së re Antikorrupsion. Në këtë raport nuk do të ketë matje të përmbushjes së objektivave nga strategjia antikorrupsion 2013-2017.

** Në këtë raport nuk është përfshirë matja e arritjes së objektivave në përmbushjen e strategjisë për reduktimin e lëndëve.

lëndëve”^{*} e cila do të jetë pjesë e monitorimit. Kjo strategji prioritetin e parë e ka: “Veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe të gjitha veprat tjera ku mund të aplikohet konfiskimi”(Prokurori i Shtetit 2015).

Vizitat në gjykata dhe prokurori - Memorandumet

Në kuadër të projektit do të bëhen vizita të rregullta në gjykatat dhe prokuroritë themelore.

Në nëntor, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe institucioneve të drejtësisë, është realizuar takimi me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z.Nehat Idrizi ku është njoftuar me projektin dhe aktivitetet e projektit. Si rezultat, me 30 janar 2017 është nënshkruar Memorandumi Bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Ky memorandum ka për qëllim bashkëpunimin reciprok ndërmjet Lëvizjes FOL dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për monitorimin e zbatimit të ligjit në gjykimet e rasteve tëkundërkorrupsionit, zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit dhe monitorimin e keqpërdorimeve në shpenzimin e parasë publike. FOL do t’i ofrojë bashkëpunim profesional KGJK-së për arritjen e qëllimeve të përbashkëta për interesin e gjyqësorit dhe publikut.

Në dhjetor 2016 është mbajtur takimi me Koordinatorin e Mekanizmave Përcjellës për Shënjestrimin e Lëndëve të Kundërkorrupsionit, z.Agim Maliqi. Takimi ka ndihmuar në përmirësimin e statistikave të kundërkorrupsionit për gjykata. Z. Maliqi gjatë takimit na njoftoi për një strategji të cilën e implementojnë bashkë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, e cila ka të bëjë me reduktimin e lëndëve të kundërkorrupsionit në gjykata. Në kuadër të aktivitetit - vizita në gjykata dhe prokurori themelore të Kosovës, është vizituar Gjykata Themelore në Ferizaj kurse në shkurt është vizituar Gjykata Themelore në Gjiilan. Memorandumi me KGJK-në ka thelluar bashkëpunimin me gjykatat themelore, duke kontribuar në zvogëlimin e barrierave të komunikimit dhe shkëmbimin më të lehtë të informatave.

^{*} Në këtë raport nuk është përfshirë matja e arritjes së objektivave në përmbushjen e kësaj strategjie.

FOL do të masë gjithashtu edhe performancën e prokurorëve dhe gjyqtarëve në shtatë gjykatat dhe prokuroritë themelore.

Matja është kryesisht statistikore dhe nënkupton numrin e lëndëve për prokurorë/gjyqtarë në prokurori/gjykata themelore për periudhën kohore 2016-2018.

Metodologjia

Duhet të theksojmë me fillim se matja e performancës së gjyqësorit nuk është punë e lehtë. Metodot për matjen e performancës janë të shumta dhe ato vazhdimisht përmirësohen. Gjyqësori është një fushë e gjerë dhe komplekse. Vendimet në gjykata varen nga shumë faktorë. Një rast mund të jetë i lehtë ndërsa një tjetër më i komplikuar; poashtu, rastet dallojnë njëri me tjetrin në bazë të numrit të të dyshuarve dhe llojit të veprës penale. Të gjitha këto dhe shumë të tjera ndikojnë në kohëzgjatjen e një rasti.

Sipas Komisionit European për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ)(CEPEJ 2015), në përgjithësi, puna e gjyqësorit matet në dy nivele; **a)** efikasiteti i gjyqësorit që përfshin kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, normën e zgjidhjes së lëndëve, fluksin e lëndëve, efikasitetin për lëndë specifike, etj si dhe **b)** kualiteti i gjyqësorit, që përfshin monitorimin dhe vlerësimin e gjykatave, strategjinë e komunikimit dhe informimit që ndihmon në uljen e kohëzgjatjes së lëndëve dhe përmirësimin e shërbimeve, trajnimin e gjykatësve dhe të tjera.

Në këtë raport, Lëvizja FOL do të masë vetëm pjesën e efikasitetit të gjykatave. Në këtë drejtim, FOL merr parasysh dhe mbështetet në formulat e CEPEJ për matjen e efikasitetit por edhe i përshtatë formulat duke u bazuar në statistikat që gjykatat dhe prokuroritë i kanë bërë të gatshme për publikim*.

Matja nuk përfshin gjithë sistemin gjyqësor dhe nuk përfshin të gjitha lëndët dhe llojet e veprave. Matja bëhet vetëm për një grup të veçantë të veprave penale, më saktësisht matja bëhet për kapitullin XXXIV të Kodit Penal të Kosovës – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437**.

Matja është statistikore dhe nuk synon të masë cilësinë e lëndëve, shërbimin e administratës gjyqësore apo cilësinë e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

* Në raportin e ardhshëm, FOL do të shtojë disa formula.

** Shiko tabelen 1: Kodi Penal i Kosovës. Kapitulli XXXIV – Korrupsioni Zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Fushat në të cilat FOL do të masë performancën e gjyqësorit dhe prokurorisë janë si më poshtë:

Lëndë të reja, lëndë të zgjidhura dhe lëndë në pritje të zgjidhjes. Numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që futen në sistem dhe që kërkojnë drejtësi, numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigja që jep sistemi i drejtësisë pra numri i lëndëve që zgjidhen. Lëndët që priten të zgjidhen janë numri i lëndëve që mbeten për t'u zgjidhur nga gjykata apo gjyqtari, në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten.

Fluksi i Lëndëve	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar
Shembull mbi njesinë matese	
Raste të pazgjidhura më 1 Janar 2016 (PS = raste në fillim të periudhës raportuese*)	195
Raste të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	106
Lëndë në Punë (LP)	301
Raste të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	123
Raste të pazgjidhura me 31.12.2016 (PE raste të pazgjidhura në mbyllje të periudhës raportuese)	178

$$LP=PS+I : PE=LP-R$$

* Këtu e tutje, me periudhë raportuese nënkuptohet periduha brenda një viti kalendarik

Norma e zgjidhjes së Lëndëve*

Është një indikator jashtëzakonisht i rendësishëm sepse mat raportin midis lëndëve të zgjidhura (R) dhe numrit të lëndëve të reja (I). Si i tillë, ky indikator tregon performancën e një gjykate të shprehur në përqindje.

$$\text{norma e zgjidhjes së rasteve \%} = \frac{\text{rastet e zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{rastet e reja gjatë periudhës raportuese}} \times 100$$

Shembulli:

Rastet e zgjidhura në fund të periudhës raportuese (R) (31.12.2016)	Rastet e reja gjatë periudhës raportuese (I) (01.01.2016 – 31.12.2016)	Norma e zgjidhjes së lëndëve
 123	 106	 116%

Shembull: Në këtë rast, nëse numri i lëndëve në sistem vazhdon të jetë i njëjtë, atëherë me këtë normë të zgjidhjes së lëndëve, nivelizimi do të arrihet në vitin 2027.

Raporti i qarkullimit të lëndëve

Mat raportin midis numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëvetë pazgjidhura. Ky raport e mat frekuencën me të cilën sistemi gjyqësor ose gjykata e zëvendëson numrin e lëndëve të ardhura.

$$\text{norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese}}$$

* Clearnace rate në anglisht

Shembulli:

Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese (01.01.2016 – 31.12.2016)	Numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese (31.12.2016)	Raporti i qarkullimit të lëndëve
 123	 178	 0.69
Në këtë rast, për vitin 2016 del që raporti i qarkullimit të lëndëve qëndron në frekuencën 0,69. Siç do të shohim më poshtë, një normë e tillë është e ulët dhe si e tillë vonon drejtësinë dhe ngadalëson reduktimin e lëndëve të grumbulluara.		

Trendi

Mat raportin mes lëndëve në punë dhe numrit të lëndëve të zgjidhura minus lëndët e reja.

Trendi nuk është pjesë e formulës nga CEPEJ; kjo formulë është derivuar duke marrë parasysh formulat tjera. Trendi në këtë raport nënkupton performancën e gjykatave në pastrimin e lëndëve të grumbulluara. Për të lehtësuar matjen e trendit në këtë raport, Trendi këtu llogaritet duke marrë si statike performancën e gjyqësorit në vitin 2016.

$$\text{trendi} = \frac{\text{Numri i lëndëve në punë (LP)}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura (R)} - \text{Numri i lëndëve të reja (I)}}$$

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve

Është tregues i cili mat kohën e përfundimit të totalit të lëndëve. Formula merr parasysh totalin e lëndëve për një periudhë të caktuar dhe bazuar në performancën e treguar në raportin e qarkullimit të lëndëve e kthen performancën për kryerjen e lëndëve në ditë. Ky tregues është i rendësishëm për të parë se sa kohë merr secila gjykatë për dhënien e drejtësisë. Natyrisht matja nuk tregon rastet specifike pasi në realitet një lëndë mund të marrë shumë më shumë kohë se sa një tjetër por formula merr parasysh hyrjen dhe daljen e lëndëve në sistem bazuar në performancën e treguar. Kur gjykata nuk ka lëndë të bartura, ajo trajton lëndët në kohë më të shkurtë duke bërë që drejtësia të mos vonojë.

$$\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{Raporti i qarkullimit të lëndëve}}$$

Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Është indikator i cili tregon performancën e gjyqësorit në përfundimin e lëndëve të grumbulluara. Numri i madhi lëndëve të grumbulluara është një ndër shqetësimet kryesore që ndikojnë drejtpërdrejt në vonimin e drejtësisë por edhe në rritjen e mosbesimit në gjykata. Një vlerë e lartë e indeksit të lëndëve të grumbulluara tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e rasteve.

$$\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{Numri i lëndëve të bartura në fillim të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese}}$$

Këto janë formulat dhe ky është sistemi i vlerësimit që do të përdoren për të matur performancën e gjykatave dhe prokurorive në këtë raport.

Ky është raporti i parë i publikuar nga Lëvizja FOL në matjen e këtij niveli të performancës dhe si i tillë është i hapur ndaj kritikave dhe sugjerimeve. Këto të gjetura do të diskutohen dhe analizohen në thellësi nga gjyqësori në tryeza të përbashkëta.

Mbledhja e të dhënave

Lëvizja FOL në vazhdimësi mbledh të dhënat* në fushën e korrupsionit nga gjykatat dhe prokuroritë në baza tremujore. Në kuadër të këtij projekti mbledhja e të dhënave ka vazhduar për grupin e të dhënave kundërkorrupsionit, por me bazë të zgjedhur.

Për vitin 2016 janë marrë të dhënat nga Gjykatat dhe Prokuroritë në baza tremujore dhe vjetore si më poshtë.

Neni	Kategoria	Neni	Kategoria
422	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	430	Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj
423	Keqpërdorimi i informatës zyrtare	431	Ushtrimi i ndikimit
424	Konflikti i interes	432	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
425	Përvetësimi në detyrë	433	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare
426	Mashtrimi në detyrë	434	Falsifikimi i dokumentit zyrtar
427	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	435	Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme
428	Marrja e ryshfetit	436	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor
429	Dhënia e ryshfetit	437	Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare

* Të dhënat janë siguruar përmes e-mailit nga zyra për statistika në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Prezantimi i të gjeturave

TABELA 1: Kodi Penal i Kosovës. Kapitulli XXXIV – Korrupsioni Zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Gjykatat Themelore – të dhëna për të gjitha gjykatat

Gjatë fazës së mbledhjes së informatave dhe statistikave, Lëvizja FOL ka kërkuar informata të përgjithshme dhe specifike në luftën kundërkorrupsionit. Të dhënat e përgjithshme janë ato informata të cilat japin një pasqyrë të përgjithshme për punën e gjykatave të cilat janë të hapura për publik kurse specifike janë ato informata të cilat gjykata i përdor për prioritete të caktuara. Për shembull, në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë, gjykatat kanë pasur prioritet që të performojnë më mirë për të përmbushur kushtin për liberalizimin e vizave (Maliqi 2016). Këto statistika janë specifike dhe nuk na janë dërguar, përkundër kërkeses për qasje në to.


Në përgjithësi, zyra për statistika në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka qenë bashkëpunuese dhe nuk kemi pasur pengesa në qasjen në informata.

Në vazhdim do të japim grafikët për të gjitha kategoritë e veprave penale në grupin e veprave “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, kapitulli XXXIV i Kodit Penal të Kosovës”.


Në Tabelën 1. i paraqitëm të gjitha kategoritë e veprave penale në kuadër të kapitullit XXXIV.

Në vazhdim do të japim grafikët me të dhëna për secilën kategori, ndërsa pastaj do të bëjmë analizën e të dhënave.

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar




Keqpërdorimi i informatës zyrtare




Konflikti i interesit




Përvetësimi në detyrë




Mashtrimi në detyrë




Përdorimi i paautorizuar i pasurisë




Marrja e ryshfetit



Dhënia e ryshfetit




Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj




Ushtrimi i ndikimit




Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore




Zbulimi i fshehtësisë zyrtare



Falsifikimi i dokumentit zyrtar




Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme




Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor



Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare



Gjykatat Themelore Statistikat Anti Korrupsion - Janar- dhjetor 2016



Analiza e numrave

Është e lehtë të humbet interesimi për numrat nëse nuk e zbërthejmë domethënien e tyre.

Çka tregojnë grafikët e mësipërm për performancën e gjyqësorit në fushën e korrupsionit? A kanë punuar gjykatat mirë? A e kanë luftuar korrupsionin?

Ajo që vërejmë nga grafikët e mësipërm është se gjykatat në gjithë territorin e Kosovës kanë pasur performancë të mirë në luftën kundërkorrupsionit, në kuptimin që ato kanë arritur të zgjidhin shumicën e lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranura.

Nga i gjithë grupi i veprave të korrupsionit, vepra penale e keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar, është vepra që përsëritet më së shpeshti e që është tregues edhe i llojit dhe nivelit të korrupsionit.

Korrupsioni zyrtar është korrupsioni i cili ushtrohet nga personi i autorizuar, i cili është zyrtar shtetëror dhe është pjesë e administratës publike (Kodi Penal 2012). Në vitin 2016, gjykatat i kanë pasur 345 lëndë në punë vetëm për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar me gjithsej 981 persona para gjykatave të cilët kanë pritur drejtësi. Nga këta 981 persona, gjykatat kanë marrë vendim për 402 persona duke dënuar me burg vetëm 31 prej tyre.

Edhe përkundër numrit të madh të lëndëve të zgjidhura për veprën penale keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar (171 lëndë) dhe numrit të personave për të cilët gjykata ka marrë vendim (402), numri i atyre që janë dënuar mbetet i vogël (31).

Nëse korrupsionin e shohim nga vendimet e gjykatave atëherë lehtë mund të argumentojmë se numri më i madh i atyre që janë korruptuar në Kosovë janë zyrtarë shtetërorë dhe jo qytetarë të rëndomtë, fakt ky që përcakton formën dhe nivelin e korrupsionit në Kosovë.

Në vazhdim do të bëjmë analizimin e këtyre numrave përmes formulave të cilat tregojnë për kapacitetin e gjykatave themelore në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit dhe performancën tyre për vitin 2016.

Fluksi i lëndëve

Bazuar në metodën e CEPEJ-it, fluksi i lëndëve do të na tregojë se si është raporti ndërmjet lëndëve të reja, lëndëve të zgjidhura dhe lëndëve në pritje. Siç u tha më lart, numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që hyjnë në sistem dhe që kërkojnë drejtësi; numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigjia që jep sistemi i drejtësisë, pra, numri i lëndëve që zgjidhen. Lëndët që priten të zgjidhen ose lëndët e papërfunduara janë numri i lëndëve që mbeten për t'u zgjidhur nga gjykata në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten.

$$LP=PS+I : PE=LP-R$$

(**LP** = Lëndë në Punë. **PS** =Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese. **I**=Raste të reja të hapura gjatë periudhës raportuese. **PE**=Raste të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. **R**=Raste të zgjidhura gjatë vitit kalendarik).

Njësia matëse:		Raste të pazgjidhura më 1 Janar 2016 (PS = raste në fillim të periudhës, të trashëguara)	Raste të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë në Punë (LP)	Raste të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	Raste të pazgjidhura më 31.12.2016 (PE raste të pazgjidhura në mbyllje të periudhës)
Shtatë gjykatat themelore. Nivel kombëtar.	Lloji i veprës penale					
	Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437	407	232	639	284	355

TABELA 2 STATISTIKAT VJETORE PËR SHSTATË GJYKATAT THEMELORE PËR VITIN 2016 PËR VEPRAT PENALE KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE.

$$(LP) 639 = PS 407 + (I) 232$$

ose

$$(PE) 355 = (LP) 639 - (R) 284$$

Siç vërejmë nga tabela e mësipërme, për të gjitha kategoritë në kuadër të kapitullit XXXIV të kodit penal të Kosovës në vitin 2016 janë bartur 407 lëndë nga viti paraprak (2015). Janë pranuar 232 lëndë të reja gjatë vitit kalendarik 2016, duke bërë që gjatë vitit 2016 Gjykatat themelore të trajtojnë 639 lëndë. Numri i lëndëve në punë (**LP**) është rezultati në mes të lëndëve të pazgjidhura nga viti paraprak (**PS**) plus numri i lëndëve të reja të pranura gjatë vitit kalendarik raportues (**I**). Ndërkaq, lëndë të pazgjidhura (**PE**) është diferenca mes lëndëve në punë gjatë vitit kalendarik (**LP**) dhe lëndëve të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (**R**).

Norma e zgjidhjes së lëndëve (CR)

Formula (CEPEJ):

$$\text{norma e zgjidhjes se rasteve \%} = \frac{\text{rastet e zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{rastet e reja gjate periudhes raportuese}} \times 100$$

Rrjedhimisht

$$\text{norma e zgjidhjes se rasteve \%} = \frac{284}{232} \times 100 = 122$$

**Norma e
zgjidhjes së
lëndëve për
2016**

122%

Në vitin 2016 shtatë gjykatat themelore në kuadër të kapitullit XXXIV të Kodit Penal të Kosovës - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, kanë pranuar në punë 232 lëndë, ndërkaq kanë arritur të zgjidhin 284 lëndë.

Sipas përlogaritjes, e duke u bazuar në formulën e CEPEJ-it, norma e zgjidhjes së lëndëve është 122% për vitin 2016 në nivel kombëtar në fushën e kundërkorrupsionit.

Norma e zgjidhjes së lëndëve është tregues jashtëzakonisht i rendësishëm i performancës së gjykatave sepse kjo na tregon për kapacitetin punues të gjykatave. Bazuar në normën e përlogaritur në vitin 2016 gjyqësori ka punuar efektivisht në nivelin mbi 100%.

Nga 639 lëndë gjykatat kanë arritur të zgjidhin 284 prej tyre ndërsa janë bartur për vitin 2017 gjithsej 355 lëndë

Norma prej 100% do të ishte e dëshirueshme sikurse gjykatat të mos kishin lëndë të grumbulluara. Një performancë e tillë tregon se gjykatat kanë zgjidhur më shumë lëndë sesa që kanë pranuar në punë për vitin 2016, që është tregues se gjykatat kanë arritur të zgjidhin edhe lëndë të bartura.

Por siç do të shohim më poshtë, janë gjykatat e veçanta ato që përmirësojnë apo përkeqësojnë performancën e gjyqësorit në tërësi. Ne shpresojmë se ky raport do t'i shërbejë sektorit të drejtësisë që të intervenojë në ato gjykata ku janë evidentuar problemet për të gjetur zgjidhjet e nevojshme, sidomos në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila ka një performancë shumë më të dobët krahasuar me gjykatat tjera.

Trendi i nivelizimit të lëndëve bazuar në performancën e vitit 2016

Një numër i madh i lëndëve vazhdojnë të barten nga viti paraprak duke bërë që sistemi të vonohet në dhënien e drejtësisë. Numri i lëndëve të bartura ndikon drejtpërdrejt në performancën e gjyqësorit edhe pse niveli i performancës është mbi 100%.

Nga përlogaritja, nëse marrim për bazë normën e zgjidhjes së lëndëve të treguar për vitin 2016, gjykatat do të arrijnë të përfundojnë lëndët e bartura në vitin 2029.

$$trendi = \frac{\text{Numri i lëndëve në punë (LP)}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura (R) - Numri i lëndëve të reja (I)}}$$

Rrjedhimisht

$$trendi = \frac{639}{284 - 232} = 12 \text{ (vjet)}$$

Formula e mësipërme merr parasysh performancën e gjyqësorit për vitin 2016 dhe formulohet mbi supozimin se për 12 vitet e ardhshme, gjyqësori do të vazhdojë të ketë normën e njëjtë të zgjidhjes së lëndëve – 122%*.

Nivelizimi i lëndëve me normën e zgjidhjes së lëndëve 122% do të arrihet në vitin 2029

Nëse gjyqësori do të përkushtohet për të përfunduar numrin e lëndëve të grumbulluara për pesë (5) vitet e ardhshme, do të duhej të dëshmojë një performancë shumë më të mirë. Duke llogaritur se numri i lëndëve të reja do të jetë i njëjtë për 5 vitet e ardhshme, për të zgjidhur lëndët e bartura në 5 vitet e ardhshme, gjykatat duhet ta rrisin normën e zgjidhjes së lëndëve në nivelin 150%. Nëse 150% është norma e dëshirueshme e zgjidhjes së lëndëve atëherë gjykatat do të arrinin nivelizimin në vitin 2022.

Sa më shumë lëndë që gjykatat bartin në vitet pasuese aq më e ulët do të jetë norma e zgjidhjes së lëndëve dhe aq më shumë sistemi do të vonohet në dhënien e drejtësisë**.

* Ajo që nuk mund të bëhet në këtë raport në mungesë të të dhënave është përlogaritja e trendit të zgjidhjes së lëndëve ndër vite, defekt ky që shpresojmë të përmirësohet në raportet e ardhshme.

** http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/thematiques/Au_dela_rapport/Stawa_Adiz_general_en.pdf

Raporti i qarkullimit të lëndëve (DT – Disposition Time)

Komisioni European për Efikasitetin e Gjyqësorit (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportojë një indikator të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve i cili kalkulohet në dy hapa. Së pari, numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese* pjestohet me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese që njihet edhe si “raporti i qarkullimit të rastit”. Së dyti, ky raport i qarkullimit të rastit pjestohet me 365** kështu që indikator i kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve (DT) mund të shprehet me numrin e ditëve, për të cilin CEPEJ-i sugjeron se e thjeshtëzon kuptimin e marrëdhënies mes numrit të lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese dhe numrit të lëndëve që presin të zgjidhen (lëndët e bartura). DT në këtë mënyrë mat se sa shpejt sistemi i drejtësisë në përfundon lëndët e pranuar në punë— që përkthehet në kohën që marrin rastet për t’u zgjidhur (Hall and

Hapi i parë

Formula

$$\text{norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese}}$$

Rrjedhimisht

$$\text{norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{284}{355} = 0,8$$

Norma e qarkullimit të lëndëve për vitin 2016 qëndron në 0,8. Koha apo norma e qarkullimit të lëndëve na jep mundësi të mëtejshme për të kuptuar menagjimin e fluksit të lëndëve nga prokuroritë. Në përgjithësi, norma e qarkullimit të lëndëve dhe kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve krahasojnë numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. Norma e qarkullimit mat se sa shpejt një sistemi (në këtë rast i prokurorive) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemin për zgjidhjen e një rasti. Në mënyrë indirekte ky indikator jep përgjigje në njërin nga pyetjet më të shpeshta dhe më të rëndësishme në sistemin e drejtësisë, që është – sa zgjatë procedura gjyqësore, në këtë rast sa zgjatë procedura deri në ngritjen e aktakuzës (Hodzic & Georg)

* Periudha raportuese i referohet periudhës në të cilën raportohen statistikat. Në rastin tonë pasi statistikat janë vjetore, periudhë raportuese është i gjithë viti kalendarik.

** 365 është numri i ditëve gjatë një viti kalendarik.

Kohëzgjatja përfundimit të lëndëve (eng disposition time -DT)

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve është tregues i rëndësishëm për matjen e performancës së sistemit gjyqësor. DT krahason numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. 365* pjestohet me normën e qarkullimit të lëndëve, të gjetur në hapin e parë, në mënyrë që koha të përkthehet në numrin e ditëve. Ky indikator (DT) tregon se si gjykatat menaxhojnë fluksin e lëndëve dhe sa shpejtë japin drejtësi.

**Raporti i
qarkullimit
të lëndëve
për vitin 2016
qëndron në 0,8**

Hapi i dytë

Formula (CEPJ).

$$\text{kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{Raporti i qarkullimit të lëndëve}}$$

Rrjedhimisht

$$\text{kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{0.8} = 456,25 \text{ ditë}$$

365 është numri i ditëve brenda një viti i cili pjestohet me normën e qarkullimit të lëndëve nga shtatë gjykatat themelore në Kosovë që për vitin 2016 ka rezultuar në 0,8.

456,25 është koha e dhënies së drejtësisë nga sistemi. Pra, koha e shprehur në numër të ditëve brenda së cilëve sistemi jep drejtësinë ose përfundon një lëndë.

* Numri i ditëve brenda një viti.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara.

**Sipas
statistikave
zyrtare,
llogaritet se
në Kosovë janë
mbi 400,000**

Njëri ndër problemet kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndër vite. Sipas statistikave zyrtare, llogaritet se në Kosovë janë mbi 400,000 lëndë të papërfunduara (European Commission 2016). Ky numër kaq i lartë i lëndëve bën që të rritet mosbesimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë pasi ata duhet të presin kohë të gjatë për drejtësi.

Një indikator kyç i performancës së gjyqësorit është edhe numri i indeksit të lëndëve të grumbulluara. Në botë, shumë gjykata mbështeten në “indeksin e lëndëve të grumbulluara” (eng. backlog index),” për të treguar nivelin e performancës së gjykatës. Ky indikator përcaktohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, të pjestuar me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese. Një vlerë e lartë në këtë numër na tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e rastit. Për shembull, nëse numri është më i lartë se 1.0, gjykata nuk ka përfunduar aq raste sa ka pasur në fillim të periudhës raportuese. (Hall and Keilitz 2012, 27)

Siç shohim në tabelën 14 Mitrovica ka një numër 1.02 të indeksit të lëndëve të grumbulluara e cila në fillim të periudhës raportuese ka pasur 37 lëndë të bartura dhe ka arritur të zgjidhë 36 lëndë gjatë periudhës raportuese. Përkundrazi, vlerë shumë e lartë e indeksit të lëndëve të grumbulluara raportohet në Prishtinë me vlerë prej 2.53.

Më 1999, autorja Maria Dakolias* për të vendosur në perspektivë domethënien e numrave raportoi një vlerë prej 0.04 për Singaporin dhe 0.25 për Francën, vlera këto që tregonin për kohë shumë të shpejtë të përfundimit të lëndëve krahasur me shtetet tjera si Kili që kishte një vlerë prej 1.7 ose Ekuadori me një vlerë tepër të lartë, 7.87. (Hall and Keilitz 2012)

* Shih poashtu Maria Dakolias (1999). Court Performance around the World. World Bank Technical Paper No. 430. Washington, DC: World Bank <http://documents.worldbank.org/curated/en/1999/07/440392/court-performance-around-world-comparative-perspective;>

Formula

Formula (CEPJ).

$$\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{Numri i lëndëve të bartura në fillim të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese}}$$

Rrjedhimisht

$$\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{407}{284} = 1.43$$

Bazuar në statistikat e vitit 2016, Kosova ka një vlerë të lartë të indeksit të lëndëve të grumbulluara. Ajo që duhet të ritheksohet është se ky indeks është i nxjerrë vetëm nga lëndët për kapitullin XXXIV të Kodit Penal të Kosovës – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, bazuar në statistikat zyrtare nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe si i tillë nuk përfaqëson gjithë sistemin gjyqësor.


Poashtu duhet të ritheksohet se asnjëri nga treguesit e mësipërm nuk tregon për kohën reale të qëndrimit të lëndëve specifike në sistem, derisa ato marrin drejtësi.

Më lart paraqitëm performancën e gjykatave në nivel kombëtar. Por si kanë qëndruar gjykatat themelore veçmas? Se cila gjykatë ka performuar më mirë dhe cila më dobët, do të mund të shohim në statistikat në vazhdim.

Fluksi i lëndëve për gjykatat themelore - Kapitulli XXXIV i kodit penal të Kosovës

Gjykatat Themelore	Njësia matëse: kapitullin XXXIV të kodit penal të Kosovës	(PS = raste në fillim të periudhës, të trashëguara)	Raste të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë në Punë (LP)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	(PE raste të pazgjidhura në mbyllje të periudhës)
Prishtinë		193	81	274	76	198
Ferizaj		31	20	51	33	18
Mitrovice		37	18	55	36	19
Prizren		31	26	57	19	38
Gjilan		57	41	98	50	48
Gjakove		40	13	53	41	12
Pejë		13	33	51	29	22

Norma e zgjidhjes së lëndëve për shtatë gjykatat themelore



Bazuar në formulën për zgjidhjen e lëndëve, performancë e mirë për gjykatën është kur ajo zgjidh po aq lëndë sa ka pranuar gjatë periudhës raportuese. Tabela e mësipërme tregon se Gjykata e Prizrenit, e cila ndiqet nga ajo e Pejës dhe e Prishtinës kanë pasur performancën më të dobët në raportin lëndë të zgjidhura pjestuar me lëndë të reja. Ndërkaq, Gjakova dhe Mitrovica kanë pasur performancën më të mirë. Një ndër shkaktarët kyçë në ngritjen e performancës për Gjakovën dhe Mitrovicën është numri i ulët i fluksit të lëndëve, Gjakova pranoi vetëm 13 lëndë, kurse Mitrovica 18 lëndë.

Gjakova dhe Mitrovica kanë pasur performancën më të mirë për vitin 2016

Në këtë raport, Lëvizja FOL nuk ka bërë krahasim të normës së zgjidhjes së lëndëve ndër vite për të parë nëse fluksi i lëndëve është i njëjtë edhe për periudhat e mëhershme* por nëse një trend i tillë i fluksit të lëndëve vazhdon edhe për vitin 2017, Këshilli Gjyqësor i Kosovës mund dhe duhet t'i shfrytëzojë këto statistika për të menaxhuar procesin e reduktimit të lëndëve të grumbulluara në gjykatat me fluks më të madh të lëndëve dhe me indeks më të lartë të grumbullimit të lëndëve.

* Një matje e tillë do të bëhet në raportet e ardhshme

Trendi i zgjidhjes së lëndëve bazuar në statistikat e vitit 2016 për shtatë gjykatat themelore

Njësia matëse:	Prishtinë	Ferizaj	Mitrovicë	Prizren	Gjilan	Gjakovë	Pejë
Trendi i nivelizimit të lëndëve dhe ofrimit të drejtësisë	n/a	3.92 vjet	3 vjet	n/a	10 vjet	1.8 vjet	n/a

Bazuar në statistikat e marra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për vitin 2016, trendi i zgjidhjes së lëndëve në nivel qendror është pozitiv në kuptimin se gjyqësori në nivel kombëtar zgjidh më shumë lëndë se sa pranon gjatë një viti. Siç është cekur më lartë, në nivel kombëtar me normën e zgjidhjes së lëndëve në nivel 122%, gjyqësori do të arrijë nivelizimin në vitin 2029, por ky trend i zgjidhjes dallon shumë në nivel të gjykatave themelore.


E shprehur në vite, gjykata e Gjakovës ka kohën më të shpejtë të nivelizimit të lëndëve, e cila ndiqet nga Mitrovica dhe Ferizaji. Arsyeja qëndron në faktin se Gjakova ka zgjidhur numrin më të lartë të lëndëve që ka pasur në punë gjatë vitit 2016. Gjakova ka pasur fluksin më të ulët për vitin 2016, e pasuar nga Mitrovica dhe Ferizaji, megjithëse Gjakova ka zgjidhur numër më të madh të lëndëve në krahasim me Mitrovicën dhe Ferizajn. Nëse fluksi i lëndëve për vitin 2017 vazhdon të jetë i njëjtë, me trendin e zgjidhjes së lëndëve të treguar në vitin 2016, Gjakova do të jetë e para që do të përfundojë lëndët e bartura në fushën e korrupsionit dhe do të jetë në gjendje të ofrojë drejtësi në afatin më të shkurtër kohor në fushën e kundërkorrupsionit.

Performancën më të dobët në këtë tregues e ka Gjykata Themelore e Prishtinës. Kjo pasi përkundër performancës më të mirë në raportin mes lëndëve të reja dhe lëndëve të zgjidhura krahasur me Prizrenin dhe Pejën, Prishtina ka numrin më të lartë të lëndëve në punë, në krahasim me gjykatat tjera themelore. Prishtina gjithashtu ka numrin më të lartë të lëndëve të grumbulluara në nivel kombëtar.

Ajo që është për t'u shqetësuar është trendi negativ i zgjidhjes së lëndëve. Trend negativ i zgjidhjes së lëndëve nënkupton që gjykatat zgjidhin më pak lëndë se sa që pranojnë gjatë vitit kalendarik. Gjykata me trendin më të madh negativ është Prizreni pasi gjatë vitit kalendarik ka bartur 7 lëndë për vitin pasardhës, e pasuar nga Prishtina me 5 lëndë dhe Peja me 4 lëndë.

Nëse marrim për bazë fluksin e lëndëve (rastet e reja) dhe normën e zgjidhjes së lëndëve për vitin 2016, Prishtina, Prizreni dhe Peja nuk do të arrijnë në pafundësi të bëjnë nivelizimin e lëndëve, pra, të zgjidhin lëndët e grumbulluara. Kjo pasi për të zgjidhur lëndët e grumbulluara këto tre gjykata duhet të kenë trend pozitiv duke treguar normë të zgjidhjes së lëndëve më të lartë se 100%. Rrjedhimisht, për të gjitha gjykatat të cilat kanë trend negativ të zgjidhjes së lëndëve, formula nuk do të jetë e aplikueshme në këtë raport.

Norma e qarkullimit të lëndëve* për shtatë gjykatat themelore




Norma e qarkullimit të lëndëve në nivel kombëtar për vitin 2016 qëndron në 0,8. Norma normale e qarkullimit të lëndëve është 1.0. Norma 1.0 nënkupton se sa lëndë hyjnë në sistem brenda një viti po aq edhe dalin nga sistemi. Gjykatat që kanë numër të madh të lëndëve të grumbulluara kërkohet që të kenë një normë më të lartë se 1.0 të qarkullimi të lëndëve, por siç vërejmë nga tabela e mëposhtme, disa nga gjykatat me numrin më të lartë të lëndëve kanë performancë të dobët me një numër shumë të ulët të normës së qarkullimit.

* Sa më e madhe që të jetë norma e qarkullimit të lëndëve, aq më shumë shkurtohet koha brenda së cilës sistemi jep drejtësi pra koha për përfundimin e lëndëve.

Gjykata e Prishtinës, e cila ka nivelin më të lartë të lëndëve të grumbulluara, është nën nivelin e performancës me një normë të qarkullimit të lëndëve 0.38. Kjo normë e qarkullimit të lëndëve vjen si rezultat i performancës së dobët në zgjidhjen e lëndëve të bartura. Siç vërejtëm nga fluksi i lëndëve, Gjykata Themelore në Prishtinë ka pranuar 81 lëndë dhe ka zgjidhur 76 në vitin 2016, duke bartur vetëm 5 lëndë në vitin pasardhës, kurse Gjykata Themelore në Prizren ka pranuar 26 lëndë dhe ka zgjidhur 19, duke bartur 7 lëndë në vitin pasardhës. Megjithatë Prishtina ka një normë më të ulët se Prizreni, kjo sepse totali i lëndëve të bartura ndër vite është më i lartë në Prishtinë se sa në Prizren, çka bën që Prishtina të marrë më shumë kohë në përfundimin e lëndëve në total. Gjakova në anën tjetër shfaq normë shumë të lartë të qarkullimit të lëndëve. Kjo mund të jetë për shumë arsye; së pari, fluksi i lëndëve është më i vogël në Gjakovë se sa në Prishtinë dhe Prizren ose kapaciteti për zgjidhjen e tyre mund të jetë më i lartë se sa fluksi me të cilën përballen. Gjakova ka pranuar vetëm 13 lëndë për vitin 2016 ndërsa ka zgjidhur 41 lëndë. Duke qarkulluar trefishin e lëndëve të pranuar, Gjakova ka arritur të zvogëlojë edhe numrin e lëndëve të bartura dhe kështu duke shkurtuar kohën e pritjes për të marrë drejtësi.

Kohëzgjatja përfundimit të lëndëve (eng disposition time -DT) për shtatë gjykatat themelore




Një tregues tjetër i performancës së gjyqësorit është edhe kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve, që në anglisht njihet si “disposition time (DT)”. Ky është një tregues i rëndësishëm pasi e përkthen kohën e zgjidhjes së lëndëve në ditë, duke e thjeshtuar edhe më tej kuptimin e performancës së gjyqësorit në dhënien e drejtësisë.

Në përputhje me formulën e rekomanduar nga CEPEJ-i dhe në përputhje me rezultatet e normës së qarkullimit të lëndëve shohim se Gjykata e Prishtinës ka performancën më të keqe, me një kohëzgjatje trefish më të lartë për zgjidhjen e lëndëve se sa gjykatat tjera. Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve merr parasysh totalin e lëndëve që presin për dhënie të drejtësisë para gjykatës. Në fund të vitit 2016, Gjykata e Gjakovës ka pasur numrin shumë më të ulët të lëndëve që presin drejtësi se cilado gjykatë tjetër.

Me normën e qarkullimit të lëndëve të treguar për vitin 2016, Gjykata e Gjakovës ka kohën më të shkurtër të ofrimit të drejtësisë për qytetarët, dhe, rrjedhimisht, kohën më të mirë të zgjidhjes së lëndëve.

Sa për krahasim, qytetarët e rajonit të Gjakovës, bazuar në normën e qarkullimit të lëndëve për vitin 2016, mund të presin drejtësi nga gjykata brenda 107 ditëve kurse ata të rajonit të Prishtinës, duhet të presin për drejtësi për një periudhë prej 960 ditëve.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara* për shtatë gjykatat themelore



Duke pasur parasysh numrin e lartë të lëndëve të grumbulluara në përgjithësi në sistemin gjyqësor, është i rëndësishëm një indikator i cili tregon performancën e gjykatave në këtë drejtim. Ajo që vërejmë në nivel kombëtar është se indeksi i lëndëve të grumbulluara është mjaft i lartë me 1.43. Por nga vjen ky numër i lartë i indeksit të lëndëve të grumbulluara?

Duke analizuar të dhënat për gjykatat themelore ndaras, vërejmë se në këtë numër të lartë kontribuon Gjykata Themelore në Prishtinë pasi

* Sa më e madhe që të jetë norma e qarkullimit të lëndëve, aq më shumë shkurtohet koha brenda së cilës sistemi jep drejtësi, pra koha për përfundimin e lëndëve.

ka numrin më të lartë të lëndëve të grumbulluara, pasuar nga Prizreni. Siç e kemi theksuar më lartë, një vlerë e lartë në këtë numër tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e rastit duke bërë që sistemi të vonojë në dhënien e drejtësisë. Kur numri është më i lartë se 1.0, gjykata nuk ka përfunduar aq raste sa ka pasur në fillim të periudhës raportuese duke bërë që rastet e reja që hyjnë në sistem të vazhdojnë të barten dhe të presin për drejtësi në një kohë të caktuar në të ardhmen.

Për shembull, nga tabela 14 vërejmë se Mitrovica ka numër 1.02 të indeksit të lëndëve të grumbulluara. Mitrovica në fillim të periudhës raportuese ka pasur 37 lëndë dhe ka arritur të zgjidhë 36 prej tyre.

Prishtina në anën tjetër ka numër të indeksit 2.53. Prishtina ka pasur 193 lëndë të grumbulluara në fillim të periudhës raportuese, kurse ka zgjidhur vetëm 76 prej tyre.

Gjykatat Themelore 2016 / Statistikat antikorrupsion

Lëvizja FOL shpreson se statistikat e mësipërme do t'i kontribuojnë vetë gjykatave për të parë punën e tyre dhe për të ngritur nivelin e performancës.

Në 639 lëndë në punë që kanë qenë për vitin 2016, 1458 persona kanë pritur drejtësi nga gjykatat.

Grafikët e mëposhtëm tregojnë statistikat e kundërkorrupsionit, të shprehur në persona dhe jo në lëndë.

Arsyeja pse kemi zgjedhur të tregojmë numrat në vend të lëndëve në pjesën e mëposhtme është për të thjeshtuar për qytetarët punën e gjykatave në luftën kundërkorrupsionit.

Statistikat Antikorrupsion 2017

Persona para gjykatave	1458
Persona për të cilat gjykata ka marrë vendim.	594
Persona të bartur për vitin pasardhës	956
Persona të dënuar me burg	60
Persona të dënuar me gjobë	41
Persona të dënuar me kusht	67
Persona të dënuar me aktgjykim lirues	146
Persona të dënuar me aktgjykim refuzues	70
Dënime tjera	3
Eshte zgjidhur në mënyrë tjetër	207

Gjykata Themelore e Prishtinës

Persona para gjykatave	687
Persona për të cilat gjykata ka marrë vendim.	153
Persona të bartur për vitin pasardhës	534
Persona të dënuar me burg	21
Persona të dënuar me gjobë	10
Persona të dënuar me kusht	27
Denime tjera	1
Persona të dënuar me aktgjykim lirues	22
Persona të dënuar me aktgjykim refuzues	35
Eshte zgjidhur në mënyrë tjetër	37

Gjykata themelore e Prishtinës ka numrin më të madh jo vetëm të lëndëve në punë, por edhe të personave që presin drejtësi. Megjithatë, nëse krahasojmë numrin e lëndëve në punë me numrin e personave që presin drejtësi mes Prishtinës dhe Ferizaj e shohim që Ferizaj ka një numër më të madh të personave karshi numrit të lëndëve.

Gjykata Themelore Ferizaj

Persona para gjykatave	105
Persona për të cilat gjykata ka marrë vendim.	90
Persona të bartur për vitin pasardhës	15
Persona të dënuar me burg	8
Persona të dënuar me gjobë	6
Persona të dënuar me kusht	12
Denime tjera	0
Persona të dënuar me aktgjykim lirues	45
Persona të dënuar me aktgjykim refuzues	15
Eshte zgjidhur në mënyrë tjetër	4

Gjykata Themelore Mitrovicë

Persona para gjykatave	105
Persona për të cilat gjykata ka marrë vendim.	90
Persona të bartur për vitin pasardhës	15
Persona të dënuar me burg	8
Persona të dënuar me gjobë	6
Persona të dënuar me kusht	12
Dënime tjera	0
Persona të dënuar me aktgjykim lirues	45
Persona të dënuar me aktgjykim refuzues	15
Eshte zgjidhur në mënyrë tjetër	4

Gjykata Themelore Prizren

Persona para gjykatave	90
Persona për të cilat gjykata ka marrë vendim.	33
Persona të bartur për vitin pasardhës	57
Persona të dënuar me burg	5
Persona të dënuar me gjobë	7
Persona të dënuar me kusht	7
Dënime tjera	0
Persona të dënuar me aktgjykim lirues	12
Persona të dënuar me aktgjykim refuzues	0
Eshte zgjidhur në mënyrë tjetër	2

Gjykata Themelore Gjilan

Persona para gjykatave	227
Persona për të cilat gjykata ka marrë vendim.	92
Persona të bartur për vitin pasardhës	135
Persona të dënuar me burg	4
Persona të dënuar me gjobë	2
Persona të dënuar me kusht	10
Dënime tjera	2
Persona të dënuar me aktgjykim lirues	19
Persona të dënuar me aktgjykim refuzues	5
Eshte zgjidhur në mënyrë tjetër	50

Gjykata Themelore Gjakovë

Persona para gjykatave

166

Persona për të cilat gjykata ka marrë vendim.

150

Persona të bartur për vitin pasardhës

16

Persona të dënuar me burg

2

Persona të dënuar me gjobë

7

Persona të dënuar me kusht

5

Dënime tjera

0

Persona të dënuar me aktgjykim lirues

27

Persona të dënuar me aktgjykim refuzues

8

Eshte zgjidhur në mënyrë tjetër

101

Gjykata Themelore Pejë

Persona para gjykatave	125
Persona për të cilat gjykata ka marrë vendim.	38
Persona të bartur për vitin pasardhës	87
Persona të dënuar me burg	7
Persona të dënuar me gjobë	9
Persona të dënuar me kusht	4
Dënime tjera	0
Persona të dënuar me aktgjykim lirues	11
Persona të dënuar me aktgjykim refuzues	1
Eshte zgjidhur në mënyrë tjetër	6

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar

Persona para gjykatave	981
Persona për të cilat gjykata ka marrë vendim.	402
Persona të bartur për vitin pasardhës	579
Persona të dënuar me burg	31
Persona të dënuar me gjobë	15
Persona të dënuar me kusht	37
Dënime tjera	95
Persona të dënuar me aktgjykim lirues	48
Persona të dënuar me aktgjykim refuzues	0
Eshte zgjidhur në mënyrë tjetër	176

Përfundim

Ky është raporti i parë i këtij lloji nga Lëvizja FOL i cili mat me numra dhe formula të sakta performancën e gjyqësorit në luftën kundërkorrupsionit.

Duke qenë një organizatë me përvojë të gjatë në luftën kundërkorrupsionit, Lëvizja FOL ndan shqetësimin për nivelin e lartë të korrupsionit qeveritar dhe performancën e dobët të gjyqësorit në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Përtej numrave është thirrje për të parë punën e gjyqësorit përtej statistikave të pakuptueshme. Nëse puna e gjykatave shikohet vetëm përmes numrave ne nuk do të arrijmë ta kuptojmë përnjëmend punën e gjyqësorit dhe prokurorisë. Nga raporti lehtë mund të vërehet se gjyqësori, në përgjithësi, ka treguar performance të mirë në luftën kundërkorrupsionit për vitin 2016.

Por numrat nuk arrijnë të na tregojnë se a kanë qenë vendimet e gjyqësorit meritore, a ka qenë drejtësia e drejtë, a kanë qenë vendimet e ndikuara nga politika, apo ndoshta edhe nga vepra korruptive brenda gjyqësorit?

Ajo që ky raport tregon është se gjyqësori ka pasur sukses në trajtimin e lëndëve të kundërkorrupsionit, duke trajtuar një numër të madh të tyre dhe duke mos vonuar drejtësinë.

Raporti thjeshton kuptimin e performancës së gjyqësorit duke i përkthyer dhe analizuar numrat në fjalë që kanë kuptim.

Por gjyqësori nuk duhet të jetë i vetëm në luftën kundërkorrupsionit. E gjithë shoqëria duhet të kontribuojë në luftimin dhe parandalimin e tij sepse të gjithë humbin nga pasojat e korrupsionit.

Në këtë raport Lëvizja FOL është përpjekur që të ofrojë një pasqyrë për gjyqësorin që ai ta shohë vetveten, ta masë vetveten dhe ta gjykojë vetveten.

Gjakova ka shumëçka për t'i mësuar Prishtinës në menaxhimin e lëndëve të grumbulluara. Kurse Prizreni duhet të mësojë shumë nga Gjakova, Ferizaji e Mitrovica sa i përket ofrimit të shpejtë të drejtësisë.

Besimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë nuk arrihet për një ditë. Për afër dy dekada qytetarët janë ndjerë të zhgënjyer me punën e gjykatave duke pritur me vite të tëra për drejtësi. Prandaj kërkohet një punë shumë e madhe për të fituar besimin.

Ky raport është vetëm një nga përpjekjet për t'i sjellur qytetarët më afër drejtësisë përmes shpjegimit të punës së gjykatave.

Perceptimi mund të luftohet vetëm përmes argumenteve të bazuara në fakte.

Ky raport bën pikërisht këtë; në njërën anë ndihmon qytetarët për të kuptuar punën e gjyqësorit kurse në anën tjetër i ndihmon gjyqësorit që ta rrisë performancën.

Lëvizja FOL do të publikojë raporte periodike për punën e gjykatave dhe prokurorive në muajt në vazhdim.

Raportet e ardhshme do të përfshijnë edhe performancën tremujore por edhe një analizë më të gjerë me indikatorë shtesë.

Bibliografia

European Commission . 2016. <http://europa.eu/rapid/search.htm>. May 4. Accessed March 02, 2017. http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-1626_en.htm.

CEPEJ. 2015. "CEPEJ Guidelines."

COMMISSION, EUROPEAN. 2015. COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT. KOSOVO* 2015 REPORT. Progress Report, EUROPEAN COMMISSION, Brussels: EUROPEAN COMMISSION, 69.

Dakolias, Maria. 2014. "Court Performance Around the World: A Comparative Perspective." Yale Human Rights and Development Journal (Human Rights Law Commons) Volume 2 (Issue 1 Yale Human Rights and Development Journal): 57.

Dakolias, Maria. 1999. "Court Performance Around the World: A Comparative Perspective. Volumes 23-430."

Department of State, US. 2015. "Kosovo Human Rights Report."

Hall, Dan H, and Ingo Keilitz. 2012. "Global Measures of Court Performance. Discussion Draft Version 3 ."

Hall, Dan H., and Ingo Keilitz. 2012. Global Measures of Court Performance. Discussion Draft, Discussion Draft Version 3, International Framework for Court Excellence, 51.

Hodzic, Adis, and Stawa Georg. n.d. "What can be said on clearance rate and disposition time (and some more)?"

KGJK. 2016. "Raporti vjetor per Grupin e veprave penale qe lidhen me korrupsion."

KGJK. 2013. "Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra."

Kodi Penal, i Republikës së Kosovës. 2012. "Korrupsioni Zyrtar dhe Veprat Penale kundër Detyrës Zyrtare."

KPK. 2016. "Raporti Vjetor per Grupin e Veprave Penale qe lidhen me Korrupsion."

Maliqi, Agim. 2016. Intervistë rreth strategjisë për reduktimin e lëndëve të kundërkorrupsionit në gjykata

Prokurori i Shtetit, Zyra. 2015. “Strategjia - Prioritetet e Prokurorive Themelore në Kosovë në ndjekjen e kryesve të veprave penale dhe hetimin e veprave penale në përgjithësi dhe reduktimin e numrit të lëndëve.”

UNDP - Kosove. 2016. “Pulsi Publik XI.” Ankete, UNDP - Kosove, Prishtine, 22.

Shënimet për gjykatat

- **Numri i personave para gjykatave** – Numri i personave është subjekt i ndryshimit. Në mungesë të një sistemi unik të numrit të lëndëve, lëndët marrin numër të ri sa here që rikthehen në shqyrtim. Psh: Kur apeli rikthen një lëndë në themelore ajo regjistrohet si lëndë e re që bënë që numri i njëjtë i personave për të njëjtën lëndë të rritet dyfish, e njëjta ndodhë edhe kur Supremja kthen në Themelore. Si rezultat, numrat e personave që presin drejtësi para gjykatave mund të mos jetë i njëjtë me numrin e personave të akuzuar nga prokuroria.
- **Për më tepër**, numri i personave të akuzuar në aktakuzën e prokurorisë mund të ndryshojë duke u shtuar apo hequr persona. Këto ndryshime reflektohen në raportin e gjykatave për persona.
- **Sa i përket numrit të personave të dënuar** – ndodhë që i njëjti person të marrë më shumë se një denim, si rrjedhojë numri i dënimeve mund të jetë më i madh se numri i personave të dënuar
- **E njëjta ndodhë edhe me numrin e lëndëve**. Lëndët që rikthehen për gjykim ato marrin një numër të ri dhe si të tilla konsiderohen si lëndë të reja.
- **Sa i përket dënimit “është zgjidhur me mënyrë tjetër”** – në këtë pjesë hyjnë një seri i dënimeve. Këtu hyjnë parashkrimi i dënimeve, aktakuzat e hedhura si dhe ricilësimi i lëndëve.



Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

